

TUFË URATASH



GROTTAFERRATA
Shtypshkronja « Shën Nilë »

— 1942 —

TUFË
URATASH



GROTTAFERRATA
Shtypëshkronja «Shën Nilë»
1942

U pa dhe u pëlqye
Grottaferrata, 15 Gusht 1942

Arhimandritë Eksark

✠ ISIDORË KROÇI

Tufë uratash!

Vëllezërve të dashurë shqiptarë e dhurojmë.

Përbanë katër pjesë:

I. - Urata të ndryshme si mbas nevojës të shpirtit krishterë.

II. - Vjersha fetare bashkërisht me muzikën e tyre.

III. - Mësime të para të Katekizmit.

IV. - Mënyra me shërbye Liturgjin.

Pjesa e parë është e përkthyme nga libra liturgjike prej Prof. S. Kolea.

Pjesa e dytë është marrur nga « Canti Sacri » G. Schirò, Napoli 1907, (N. I-XIII) e nga « Kënga të shëntëruara » G. D. Qirias, Sofia 1906 (N. XIV-XVII).

Pjesa e tretë është e përkthyme prej të përmendurit Prof. S. Kolea nga teksti i Katekizmit Piut X me ndryshime të lehta ndër pjesë që i përkasin ndër çerimonina Lindore.

Pjesa e katërtë është e marrur nga botimi: Fan Noli sot e përdorur në Shqipëri.


Grottaferrata, 6 Gusht, 1942.

At LORENC TARDO

ΑΓΙΟΣ ΑΓΙΟΣ ΑΓΙΟΣ



ΚΥΡΙΟΣ ΘΑΒΑΩΘ



URATA TË MËNGJELITË

Shënt Perëndi, Shënt i Fuqishmë, Shënt i Pavdekur, mëshirô-na.

Lavdi Atit e Birit edhe Shpirtit Shënt, tanî e përherë, e në jetë të jetëve. Amin.

Trinî e Tërëshëntë, mëshirô-na. O Zot, fali mëkat tona. O Zot i Math, ndjej-i paudhësitë tona; o i Shëntë, vështroj-i dhe shëroj-i sëmundjet tona për emërin t'ënt. Mëshirô, o Zot, mëshirô, o Zot; mëshirô, o Zot.

Ati ynë që je ndë qiell, u-shëntëroftë emëri yt. Arthtë mbretërija e jote, u-bëftë dëshira e jote si ndë qiell edhe mbi dhë. Bukën tonë të përditëshme ep-na-e neve sot; edhe fal-na-i fajet tona, sikundër edhe ne u a falim fajtorëve tanë, edhe mos na shtier ndë ngasje, po shpëtô-na nga i ligu. Se jotja është mbretërija, edhe fuqia edhe lavdia e Atit e Birit edhe Shpirtit Shënt, tanî e përherë, e në jetë të jetëve. Amin.

Të ngriturë nga gjumi, të bjemë ndër këmbë, o i Mirë, ty, dhe ty, o i pushtetëmë, të këndojëm' me zë, lavdërën' e Engjëjvet': I shenjtë, i Shenjtë, i Shenjtë je, o Zot; me hirin' e të luturavet' të Nënës' së Zotit, kij për ne mëshirë.

O Zot, që më bëre, të ngr'hem i gjallë nga gjumi dhe nga shtrati, më ndritëshò mëntë, dhe çel-më zëmër' e buzë, që, ty Trinij' e Shenjtë, të të lavdëronj: I Shenjtë, i Shenjtë, i Shenjtë je, o Zot; me hirin' e të luturavet' të Nënës' së Zotitë kij për ne mëshirë.

Dotë vinj' mbë papriturë, Gjqëtar i hyjëmë, dhe veprat' të silitë do dalin' në faqe; po ne, në mes të natësë, do këlthijëm' me frikë: i Shenjtë, i Shenjtë, i Shenjtë je, o Zot; me hirin' e të luturavet' të Nënës' së Zotitë, kij për ne mëshirë.



I ngriturë nga gjumi, vinj të të falem ty e Shenjta Trinijë; sepse nga e shuma mirësija e jote, dhe nga durim' i math e i tepërë, nuk' uzëmërove me mua të plogetin' edhe mëkatarinë, dhe nuk me shduke bashkë më paudhërijatë, po të udhims për mua, dhe tek qesh' i humburë, më ngrite të mëngonj, për të lavduruarë pushtetin t' ende.

Dhe tashti shëndri-më sitë të mejtimitë, çel-më gojën' t'ime të munt të thellonj fjalët që ke thënë, dhe të kupëtonj porosijatt' t'ënde, dhe të vënj në vepërë dëshërimin' t'ënde, dhe të rënj lavdëra, me zëmër' të penduarë, dhe të lumëronj emërin' të Atit' e të Birit' e të Frymës' së Shenjtë, tanì e për gjith' mon' e në jet' të jetëvet'. Amin.



Besoj më një Perëndi, Atin e tërëfuqishim, krijëtarin e qiellit e të dheut, dhe të gjithë të dukurave e të padukurave.

E në një Zot Jesu Krisht, të vetëm Bir të Perëndisë që lindi prej Atit para gjithë jetëve.

Dritë prej drite, Perëndi e vërtetë prej Perëndie të vërtetë, që lindi e nuk' u-bë, të bashkëqënurshëm me Atin, me anën e të cilit u bënë të gjitha.

Që për ne njerëzit dhe për shpëtimin tonë xbriti prej qiejvet dhe u-mishërua prej Shpirtit Shënt dhe Virgjërës Marí dhe u-bë njeri.

Që u-kryqësua për ne më kohë të Pontit Pilat dhe vojti dhe u-varrua.

Dhe u-ngjall më të tretën ditë pas Shkronjavet. Dhe u-ngjiti në qiell e ndënji më të diathtë të Atit,

dhe do të vinjë prapë me lavdi të gjykojë të gjallët e të vdekurit, mbretëri' e të' cilit do t'mos ketë mbarim. Dhe më Shpirtin Shënt, Zotin e Jetëdhënësin, që dërgohet prej Atit, që adhurohet e lavdërohet bashkë më Atin e me Birin, që foli me anën e Profetave.

Më një Kishë të Shëntë, të Pergjithëshme, dhe Apostollore.

Rrëfej një Pagëzim për ndjesë të mëkatëve.

Pres ngjalljen e të vdekurve dhe jetën e botës që vien. Amin.

Urata Sh. Mërijesë

Ty, o Nën' e Zotitë, të kam kushtuarë shpirtinë, dhe trupin' edhe zëmrënë dhe mëndjenë t'ime; fal'i shpirtit' t'im' ato që janë për të të mira dhe të mbara dhe më shtyp në trup lakëmiot' të mishitë; këthill-ma zëmëren' t'ime, e thjeshta mbi të thjeshtatë, dhe step-më nga të sjellurat' të prapa të mëndjesë. E dlira mbi të dliratë, tultat-më trubullimet' që më kanë ngjallurë mëkatat e mija.

Ty Të kushtova shpirtinë, o Zonjë: ti me prij; ti ruaj-më dhe shpëto-më së ligës edhe leqevet që më ngref armiku, i cili, pa pushim, më loth e më mundon.

Urata për Engjëllin' e Rojesë

O Engjëll' i hyjiëmë, i shënuar' nga Zoti
për të më ruajturë shpirtinë, pas shëmbëllës' së
tijë, këqyr 'gjithë mëkatat' të shpirtit' t'im', të



ngratë, me sy përdëllimi; shpëto-më nga leqet' të
shuma të të ligutë, dhe lut'iu Perëndisë të më
ket' mëshirë në ditën' e gjyqitë.

O Engjëll' i Shenjtë, që je Kuidestar mbi shpirtin' t'im' të ngratë, dhe mbi jetën' t'ime p'ot' helëm' e hidhërime, mos më lër nga dora, mua më-katarinë, dhe mos m'ulargë për shkak se kam qënë i sdredur' e pafrënë jetënë t'ime; mos i lër shesh të ligutë, të më vërë poshtë, tuke më mburrusurë këtë trup të mortënë; më mba dorën' t'ime, të dobët' e të ngáthetë, dhe më prij në rru-gën' që çon në shpëtim. Po, vërtet', o Engjëll'i shenjt' i Perëndijësë, ti që ruan e mpruan shpir-tin' t'im' të mjerë edhe trupin' t'imë, më fal për gjithë fajet që të kamë hidhëruarë ç'do dit të jetës s'ime, dhe për ato që ndofta të kam bërë sonte (të kam bërë sot), dhe pruj-më edhe sot (edhe sonte) nga gjithë të ngaçmuarat' të kundrështarit' t'im', që mos të bjenj në faje, të zë-mëronj Zotinë dhe lut'iu Perëndijësë, të më fortësonjë në frikën' e tijë, dhe të më bënj' të vlerë për të qënë robi i mirësisjës' së tijë. Amin.

Uratë mbë të ndenjurë në bukë

Bekò, o Krisht o Zot, të ngrënët' dhe të pirët të robëvet' të tu, se je për jet' i Shenjtë, tanì e për gjith' mon' e në jet' të jetëvetë. Amin.

Urata mbë t'ungriturë nga buka

I Bekuarë Zoti, që na ka mëshirë dhe na ka ushqyerë që mbë të rijet' t'ënë; ti që i ep ushqiminë ç' do trupi të gjallë, plo-na me gëzim dhe ngazëllim zëmratë, që ne, tuke pasurë për vehte gjithë herë gjithë sa na duhenë, të mundim' me të tepërë, të derdhim' ndihmën' t'ënë, për ç' do vepër' të mirë, në ëmër' të Jesu Krishtitë, t'ën' Zoti, që bashkë me të cilinë dhe bashkë me Frymën' e Shenjtë, të ka hije lavdi, pushteti, nderim' e adhurimi, për të gjat' të shekujvetë. Amin.

Për ty, o Zot, lavdî, për ty, i Shenjtë, lavdî, për ty, o Mbëret, lavdî që na dhe ushqiminë dhe na gëzove zemërënë; na plo tashti shpirtinë me Frymë të Shenjtë, që, përpara teje, të dalim' faqebardhë, dhe mos të turpërohemi, kur të shpërblejsh sicilinë pas veprave' të tija.





URATA TË MBRËMJESË

Të falem, o Zot, për ditën' që shkova; të lypënj të shkonj dhe darkën dhe natën' pa rën' në mëkatë, ashtu, o Shpëtimtar, mi' fal edhe shpëto-më.

Të lavdëronj, o Zot, për ditën' që kalova; të lypënj të shkonj dhe darkën' dhe natënë pa rënë në ngacmije; ashtu, o Shpëtimtar, m'i fal edhe shpëto-më.

Të lumëronj, i Shenjtë, për ditën që shkova; të lypënj të shkonj dhe darkën' dhe natënë pa ngecur' në leqet' të frymës' së ligë; ashtu, o Shpëtimtar, m'i fal edhe shpëto-më.

Ti më shëndrî sytë, Krisht o Perëndi, se mos më zërë gjumi i rëndë si mortja; që mos të ket' armiku të thot: E vura poshtë.

Ti m' ubëj, o Zot, ndihmëtar i shpirtitë, sepse kam të shkonj për mes shumë kurthesh; ti syrësh më ruaj e më shpëto, i Mirë, si zëmërdhimshurë që je për njerëzijenë.

Ti, o Zot, e din se s' kanë të fieturë armiqët' të mij, që nuk' i shef syri, dhe ti prap' e din

sa i dobët është ky mishi i im' i mierë, që ti krijove vehtë; andaj' në duarët' t'ënde do besonj shpirtin' t'imë. Mbulo-më me krahët' të mirësijës s'ate, se mos më zërë gjumi i rëndë si vdekja; shëndrî-më syt' të mëndjesë me dritën' e fialëvet' të hyjëme t'ënde; dhe sgjò-më nga gjumi në kohën' e voliturë, për të të lavdëruarë, si i Mirë i vetëm që je, dhe që të dhimsurë ke për njerëzijenë.

Sa dot' jet' i tmerrëmë gjyqi i yt', o Zot, kur përpara Engjëjvet', të dalin' njerëzija, të hapën' radhuarëtë, të sqyrëtohen' vepërat; të qyren' mejtimetë. Qysh ka për të qënë pleqnimi për mua, të zërin' në mëkatë? Kush dot' më shuanjë flakënë? Kush dot' më shdrinjë të errëtit'? Po s' pate mëshirë, ti, o Zot, për mua, si zëmërdhimsurë që je për njerëzijen.



Dhe ep-na, o Zot, tek' vemi për të fieturë, të prëjtë trup' e shpirti; dhe ruaj-na nga gjumi i verbët' i mëkatësë, dhe nga ç' do të shfaqurë të errit' dhe të natësë. Tulat ndezën' e ephëvetë, shuaj-i shigjetatë, të ndezëta flakë, që sjellën kundër' nesh i ligu me kobë; step ndër ne të shkulumëtit' të digavet të mishitë, dhe fik-na gjith


mejtimet që kanë të bëjnë me baltën dhe me lëndënë. Dhe na fal, o Zot, mëndje të vërgjilëtë, gjyqime të urtë, zemërë të esullë, të fjeturë të lehëtë, të dlirturë nga gjithë trillimet të të ligutë. Dhe na sgjò nga gjumi, për kohën' e uratësë, të mbajtur' të patundurë mbi porosijat' t' ende, dhe me të kujtuarët' të gjykeqevet t'ënt', të ngulur pa të luajturë në mëndjenë t'ënë. Na fal që për-nata të kemi në gojë të lavdëruarët' t'ënt që të lumërojëmë, dhe të të bekojëmë, dhe të të lëvdojëmë të nderëtin' së gjithash dhe të madhësh-tuarin' emërinë t' ënt, të Atit' e të Birit' e të Frymës' së Shenjtë, tanì e për gjith' mon' e për jet' të jetëvetë. Amin.

Urata Zotit' Krisht nga ana e fëmijëve

O Zoti Jesu Krisht, që qase në prëhëre fë-mijët' të vegjëlë, kur të erdhën' përënë, prit dhe prej gojës' s'ime, që jam fëmijë i ytë, këtë uratë darke; ruajmë ndënë hijen' e krahavet' të tu, që të më zërë gjumi dhe të flenj i qetë; dhe më sgjò nga gjumi, në kohën' që duhetë, për të të lavdëruarë, si i Mirë i vetëmë që je, dhe që të dhimsurë ke për njerëzijenë.

Uratë për të rriturit në moshë

Yn' Zot o Perëndijë, në qoftë se kam rënë në mëkatë sot me fialë, me punë dhe me të menduarë, më fal si i Mirë që je, dhe që të dhimsurë



ke për njerëzijenë; më ep gjumë të qetë dhe të patrubulluarë dhe ruaj-më e shpëto-më nga gjithë të msyjturat' dhe kurthet' të të ligutë; dhe ngrej-

më nga gjumi në kohë të voliturë, për të të lavdëruarë se ti je i bekuarë me Birin' t' ënt të vetëmë, dhe me Frymën' t'ënde të shenjtë mbi të shenjtatë, sot e për gjith' mon' e për jet' të jetëvetë. Amin.



URATA SH. MËRIJËSË

O Virgjër' Nën' e Zotitë, gëzuash o e gëzuarë, Mërijë Hirëplotë, yn' Zot baskë me ty; e bekuarë ti ndër gjithë grat, dhe e bekuarë pema e gjiritë t'ënt, se Shpëtimtarin' linde të shpirtëvet' t'anë.

Ndënë mëshirën t'ënde vijëm' të shtrehim' kryetë, o Nën' e Perëndijësë, mos na huth tej' të luturat' në ditë të ngushtë, po na shpëto rreziqëvet' e vetëma e dlorë, e vetëma e bekuarë.

Po pata shpresën' t'ëndë, që nuk' ka të fikurë, o Nën' e Perëndijësë, do kem edhe shpë-



O Shën Mërija, lutu për ne.

timinë; kur të kem mprojën' t'ënde, e dlira mbi të dliatë, nuk dot' kem më frikë; i veshurë me hijen' e mprojës' s'ate vetëmë, si me pëqir të he-kurtë, dot' u bjenj në shpinë armiqëvet' të mij' dhe dot' u apënj dërmënë; dhe, mbë të rën' ndër këmbë për ndihmënë t'ënde, pa an' e masë të fortë, të klithënj me të madhënë: Më sgjò, ti, o Zonjë, nga gjumi i errësirësë, për të të lavdëruarë, me hirin' e fuqijësë, që ke nga Bir' i Zotitë, i cili përmes teje mori trup njeriu.



URATË PËR RRËFIMINË

O Zoti Krisht, o Perëndi, ti që me të vuajturat' të tua mjekove të vuajturat' të mija, dhe më shërove plagëtë me plagët' të tua, më fal të derdhënj lotë nga thelbi i zemërës' për fajet' të shuma që ty të kam berë; më sbut trupin' t'im' me erën e trupit' t'ënt, që falën jet' të gjallë, dhe ëmbëlso-më shpirtinë, me gjakun' t'ënt të shtrenjtë, nga helmi që më bëri të pinj i kundrejmi.

Larto gjer tek ti mënt' të mij' që janë rrëkëlyerë poshtë, dhe nxir-më nga të thellat' të gavërës' së humbjesë; se nuk kam të penduarë, s'kam të ngashëryerë të shpirtit' dhe të zëmëresë, nuk kam lotë të luturi, lotë që, si bir, të munt të më këthejën' në trashëgim të vehtë.



Më është errurë mëndja pas trocevet' të jetësë, dhe s'kam më fuqijë të ngrenj syt' tek' ti me zëmërë pikëllimi, nuk ngrohem dot' me lotët' të mallit' për ty.

Porse ti, o Zot, Zoti Jesu Krisht, thesar' i gjithë të miravet', me fal pendim të plotë, dhe zëmërë

të palodhurë për të të kërkuarë; dhuro-më hirin t'ënt, dhe përsëri tek unë duk' e shëmbëllimet' të fytyrës' s'ate. Un' ika e të lashë, po ti mos më lër; dil të më kërkosh, çomë përseri në kullotën' t'ënde, më qas bashkë me berret' të grigjës' që kë sgjedhurë, dhe mba-më njësh me 'ta me barin' e mështerëvet' të hyjëme të tua; me hir të të luturavet' nga an' e Nënës' s'ate, të dlires' mbi të dliatë, dhe nga an' e gjithë shenjtorëvet' të tu. Amin.

Uratë Zotit' Krisht për t'i kërkuarë pendesë

Më ep të derdhënj lotë sikundër, o Zot, i dhe një hërë moti gruas' mëkatare, dhe fal-më të të lagënj me lot' këmbët' të tua, që më kan' shpëtuarë nga rruga e gabimitë, dhe të të shtronj përpara, si erë të myshkëtë, një jetë të kulluarë, të ndrequr' nga pendimi; që të dëgjonj dhe unë zërin' t'ënt të thotë fjalët' që uron shpirti: Të shpëtoj' besimi i ytë, shko në rrugë të paqitë.



Do donjam, o Zot, me lotet' të mij' të shlyenj nga radhuari fajet' që kam bërë, edhe sa më mbetet' të rronj më në jetë, t'e shkonj në të

penduarë, o Zot, për të të sbuturë; po më kohon armiku, dhe më lufton shpirtinë; ti, o Zot, shpëto më gjer sa s'kam harriturë në fundin' e humbjesë.



URATA PARA KUNGIMITË


Besoj, o Zot, dhe rrëfej se ti je me të vertetë Krishti, i Bir' i Perëndisë së gjallë, që erdhe në botë për të shpëtuar mëkatarët, nga të cilët i pari jam unë.

Edhe besoj se ky është vetë Trupit yt i kulluar, dhe ky është vetë Gjaku yt i çëmuar. Të lutem pra: mëshirô-më, dhe ndje-m' i fajet, të dashura dhe të padashura, me fialë, me punë, me dijë dhe padijë, dhe vlerësô-më të pjesëtoj pa dënim Mysteret e tua të kulluara, për ndjesë mëkatash, dhe për jetë t'ameshuar. Amin.



Më ngazëllove me mall, o Krisht, dhe më ndryshove me dashurinë tënde perëndishme; po digj-i mëkatat e mia me ziarr te palëndëshm dhe vlerësô-më të rrafshohem me gëzim te ty, që të madhështoj, duke kercier ardhiet e tua të dyja, o i Mirë.

Nër shkëlqimet e shëntorëve t'ënt si do të hyj unë i pavyeri? se, në guxofsha të hyj bashkë në nu-sëroren, këmisha më tregon, se s'është e dasmës, dhe i lidhur do të nxirem jashta prej Engjëjve. Spastro, o Zot, ndyrësin' e shpirtit t'im dhe shpëto-më si njerzidashës.



Merni hani ky është trupi im

O Zot njerzidashës, Zoti Jesu Krisht, Perëndia ime, të mos më bëhen për gjykim këto të shënta, nga që jam i pavyer, po për paqësim dhe shëntërim shpirti, dhe trupi, dhe për vlesim të jetës dhe Mbretërisë së ardhëshme. Është e mirë për mua

t'i ngjitem Zotit', dhe të vë te Zoti shpëresën e shpëtimit t'im.



Nuk' e vëjenj, o Zot, të hyjsh ti ndënë strehën' e shpirtit' t'im' të skilloqurë; po, sikundër qase të shtrihesh në shpellën' dhe në grazht të kafshëvet', dhe të rrijsht në vatërën' e Simon të strokurit', tuke unjgur' vehtenë gjer mbë të qasur' përanë gruan' mëkatare, si ç' jam edhe vehtë, po ashtu pëlqe të hyjsh tashti në grazhdin' t'im të kredhur' në këllirë, se dhe vehtë jam i vdekur' dhe i strokurë; dhe si nuk' t'ugërdit' nga goja e ndohët' e gruas' së ligë, kur të puthëte këmbët' të tua të shenjta, gjithaqas, o Zot, o Perëndija e ime, mos të të vinj' të ndohë nga unë mëkatari; po si i Mirë që je dhe dhimsurinë ke për nje-rezijënë, më fal të marënj pjesë dhe unë nga i shenjti përmbi gjithë të shenjtëtë, trupi dhe gjaku i ytë.



Kungimi që po marënj, o Zot, nga mëshëtarët' e tu të shenjtë, mos qoftë për qertim a për dë-nimin' t'im, po për të shëruarë shpirtin t'im dhe trupin.

URATA TË FALURI NDËRSE PAS KUNGIMIT

Te falem ty, o Zot, o Perëndija e ime, se nuk' më hudhe tejë mua mëkatarinë, po më bërë mbarë të hynj pjesëtar në shënjtërimet' t'ënt. Të falem se me gjithë që nuk' e vëlenj, pëlqeve të kungonj



dhuratat' të tua, të këthill' e të ku'luara, të sbri-tura qjellitë. Po, o Zot, që dhimsë ke për njerë-zijënë, që për ne dhe vdiqe dhe ungjalle prapë dhe që për të bekuarë dhe për të shenjtëruarë shpirt' trupet' t'anë, na dhe këto mështere, dhu-rata drojëplota që falin' jet' të gjallë, bëj që dhe për mua të jenë për shërim të shpirtit' dhe të

trupitë, për të shporru' largë ç'do far' prapësije, për t'u dhënë dritë syvet' të zëmërës s'ime, për të më paqësuarë fuqijat' për të shpirtitë, për besë të patundurë, për dashurim të thjeshtëmë, për të më shtuarë dijënë, për të mbajt' e ruajturë porosijat' t'ënde, për të më shumuarë hirin' t'ënt të hyjëmë dhe për t'uaviturë në mbretërijën t'ënde; që tuke qën' i prujturë, me anën' e tyre, në shenjtërimin' t'ënt, të kem të kuitonj hirin' t'ënt gjith' monë, dhe më të mos rronj për vehtenë t'ime, po për ty, Yn' Zot dhe bamirës i ynë. Dhe kur të vinjë dita, të ndahem nga kjo botë, me shpëresën' e njëj jete që nuk ka të mbaruarë të shkonj në të prëhëtit' që nuk ka të sosurë, ku, pa të pushuarë, kumbojën' brohorijat' të lume të atyre që Kremtojnë festë dhe ku mbretëron, pa an'e pa masë, gëzim'i atyre, që në fytyren' t'ënde këqyrin' bukurijënë, që nuk gjindet' goja të munt' t'e rrëfenjë. Se ti je për ata që të kanë mallinë, dëshira e vërtetë edhe të ngazëllyerët' që s'ka si tregohetë, o Krisht, o Zot i ynë, dhe ty të lumëron Krijesa e tërë, për të gjat' të shekujvet'. Amin.



Të falendërojmë, o Zot njerësdashës, mirëbërës i shpirtëvë tona, se dhe me ditën e sotme

na vlerësovë për Mysteret e tua qiellore dhe të pavdekura; pre-na-e drejt udhën, pshet-na ne të gjithë me frikën tënde, rua-na-e jetën, shigurô-na-e përçapet, me uratat dhe lutjet e Hyilindëses së lavdëruar dhe gjithmon-Virgjërës Marî dhe të gjithë Shëntorëve tënt.



Uratë e sh. Vasilit të math

Zoti Krisht, o Perëndi, Ty, o Mbëret' i shekuivet' dhe Kryejtës i gjithsejësë, të falem për të gjitha të mirat' që më dhe si dhe për të kunguarët' që pata në të shenjtat' mështeret' të tua, që falin' jet' të gjallë.

Ty pra, o i Mirë, që për njerëzijenë, je zëmë-rëdhimsurë, të lutem të më ruajsh ndënë mpro-jënë t'ënde edhe ndënë hijën' e krahëvet' t'ënt; dhe fal-më të kem pjesë në shenjtërimet' t'ënt, me zëmër' të kulluarë gjer në funt të frymësë, për të m'undjerë fajetë dhe për të gëzuarë jetë të pasosurë. Se ti je buka e jetësë, burim' i she-njtërimit, daritës i të miravetë; dhe ty të ngre-jëm' lavdinë, së bashku me Atin' dhe Frymën' e Shenjtë, tanë e për gjith' mon e në jet' të jetëvet. Amin.



Doksologjia

Të hymnojmë; te bekojmë, të falemi, të lavdërojmë, të falendërojmë për lavdinë tënde të madhe.

Zot Mbret, Perëndi qiellore, At' i tërëfuqishim, Zot Bir i vetëm Jesu Krisht edhe Shpirti Shënt.

Zot Perëndi, qengj'i Perëndisë, i Biri i Atit që ngre mëkatën e botës: mëshirô-na, ti që ngre mëkatat e botës.

Prit faljen tonë, ti që rri më të diathtë të Atit, edhe mëshirô-na.

Se ti je Shënt i vetëm, ti je Zot' i vetëm Jesu Krishti, për lavdi të Perëndisë Atit. Amin.

Për dita do t' të bekoj dhe do të lavdëroj emërin tënt për jetë e më jetë të jetës.

Vlerëso-na, o Zot, këtë ditë të ruhemi pa nonjë mëkatë.

I bekuar je, o Zot, Perëndi' e etërve tanë dhe emëri yt është i kënduar e i lavdëruar më jetët. Amin.

Le të jetë, o Zot, përdëllimi yt mi ne, sikundër kemi shpresuar më ty. I bekuar je, o Zot, mëso më të drejtat e tua. (*tri herë*).

O Zot, ke qën strehë e jonë bres pas brezi. Unë thashë: o Zot, mëshirô-më; shërô Shpirtin t'im, se fëjeva te ty.

O Zot, më ty gjeta strehën: mëso-më të bëj
dëshirën t'ënde, se ti je Perëndia ime.

Se pranë teje është burim jete, më dritën tënde
do të shëkojmë dritë.

Zgjat-e përdëllimin tënt mi ata që të njohin.

Shënt Perëndi, shënt i Fuqishmë, Shënt i Pav-
dekur, mëshirô-na.





TË LUTURA ZONJËS' SH. MËRIJË PËR NEVOIJA TË
NDRYSHËME TË JETËVE DHE PËR T'I LYPURË
TË PËRKRAHURIT' TË SAJE

E Shenjta mbi të Shenjtatë, Zonjë Nën' e
Zotitë, ti që je ndriturit' të shpirtit' t'im' të erru-
rë, ti shpëresa, ti streha, mpështetja, ngushullimi,
ngazullim' i imë, të fa'em se mua, që jam i pavle-



rë, më bëre të zotin' të hynj pjesëtar në trupin'
e shenjtë dhe gjakun e shtrenjtë të Biritë t'ënt.
Po o ti, që linde dritën' e vërtetë, shëndri-më syt'

të zëmëresë; o ti, që përftove burimin' e pavdekësë, më ngjall edhe mua që më ka vrarë faja.

O Nënë zëmëredhimsurë e Zotit' të mëshirëmë, kij përdëllim për mua dhe fal-më të ngjethurë dhe të ngashëryerë në zëmëren' t'ime, dhe frymë të përvujturi në mëndjënë t'ime, dhe sqo nga robërimi gjyqimet' të mij'. Dhe gjer në funt të frymësë, ti më bëj të zotinë të marënj shenj-tërimin' e shenjtëvet' mëshitare, me zëmërë të bardhë, që të kem shërim të shpirtit dhe trupit. Dhe më të derdhëni lotë të të lumëruar, të lavdëruarë gjith' ditët' të jetësë. Se Ti je e bekuarë dhe e lavdëruarë për të gjat të shekujvetë. Amin.



Ti, ëmbëlsim' i Engjëjvet', gëzim' i të helmuarëvetë, përkrah e të Krishterëvetë, o Virgjër' Nën' e Zotitë, vër dorën' dhe shpëto-më bështjeret' të përjetëme.

Mbas si ne nuk kemi as faqe as sy nga shkakul se të shuma jan' mëkatat t'ona, ti o e Virgjërë Nën' e Perëndijësë, lut-ju atij' që ka lindur prej teje; se ka fuqijë shumë të luturit të Nënësë, për të shatur Zotinë. Mos huth tej' të luturat' të bëra prej fajtoresh, o e nderëta, ti përmbi gjithë të

nderëtatë; se është i mëshirëmë dhe ka në dorë shpëtiminë, ay që vuri vehten' e vuajti për ne.

Brezatë të gjithë ty të lumërojënë, o Virgjër' Nën' e Zotitë; se ndë ty pëlqeu të përshijet' Krishti, Perëndija e jnë; që s'ka të përshijturë. Dhe ne jemi të lumturë që ty të kemi mprojë; se ti lute për ne ditën dhe natënë, edhe me të luturat' të tua shëndoshenë shqepet' të mbretërijësë. Andaj të këlthijëmë, tuke të lumëruarë: gëzuash o hirëplotë, Zoti bashkë me ty.



Gëzuash, o Nën' e Zotitë, e mveshura me hije përmbi gjithë sa janë të hijëshme në botë, gëzuash ti, o krua që jetën' vrijon për ne besëtarëtë; gëzuash o mbëretëshë mbi gjithë sa janë dhe zonj' e krijesësë; e bekuara ti, gëzuash o e kthillëta mbi gjithë të kthillëtat'; e lumturuara ti, gëzuash o e kulluara mbi gjithë të kulluaratë; gëzuash ti galonjë; gëzuash o bujt' e hyjëmë; gëzuash ti e dlira; e gëzuarë qofshë, o Nënë-Virgjëreshë; gëzuash ti o mblestëra e hyjëm' e Zotitë.

Gëzuash o e papëlqura Nën' e Perëndijësë; qofshë e gëzuarë o shpres' e besëtarëvetë; e gëzuarë qofshë o dlorëtar' e botësë; gëzuash që shpë-

ton robërit' të tû nga ç'do breng' e troce; e gëzuarë qofshë o ngushullim i njerësvetë; gëzuash ti ndihëmë që falën jet' të gjallë; gëzuash kështjella e gjithë sa të klithinë; gëzuash cak të ndenjuri i hyjëm' i Zotitë dhe mal i shenjtëruarë.



Gëzuash, o Mbëretëshë Nën' e Perëndijësë; gëzuash ti e vetëma shpëresë dhe ndihëmë e bijëvet' të vdekjesë; e gëzuarë qofshë o strehë shpëtimi dhe liqen i ndritëmë për jetën' e jetëse; qofshë e gëzuarë o fakull' e shkëlqaturë; e gëzuara ti ga'onj' e shenjtëruarë; gëzuash ti Parajsa, gëzuash o bujt' e hyjëmë; gëzuash ti ubëla që ndërshen me gulfa ujët gjith' atyre që kanë mpështeturë shpëresënë tek ti.



Uçfaqe qish' e shenjtë e Zotit' që s' përshihe-të, o gjithësej' e dlira, me lutjet' të tua çfaq dhe zemrën' t'ime si qishë të hirës' së tij' të hyjëmë, o mbëretësh' e shenjtë mbi gjithë të shenjtatë, dhe ruaj-më të patingurë.

O Mbëretësh' e dlirë nga ç'do zhig' e blanë, që në gjë përftove të mirin' Perëndi, shpëto-më dhe mua, që jam rob' i ytë, dhe ruaj-më të pacen

ndëshkimit' të përjetëmë, që, i shpëtuarë shpirtinë, të kem të lavduronj mërekullijat' t'ënde.

Shenjtëror' e shenjtë e Hyjit' Perëndi, m'e gjërë nga qjejetë, dhe që je m'e shenjtë dhe nga Qerubimetë, o p'ot' me hìre Zoti, Virgjëresh' e shenjtë mbi gjithë të shenjtatë, derth hiret' e tua mbi shpirtinë t'imë dhe ndrit-më syt' të zemrësë, tuke më falur' ndjesën' e gjithë mëkatavet', me lutjet' të tua, që priten' me të nxehëtë.



Ty të kemi njohurë shpërvjerë të shenjtë dhe pallat dëfrimi edhe cak të dliurë, o Virgjër' e kulluarë mbi gjithë të kulluaratë; andaj' të bjem ndër këmbë të na dliurish shpirtinë, të ndragur' shumë plëngjesh, dhe praj' e cak të ndenjuri të Frymës' së Shenjtë t'e bëjish që lavdurata të të këndonj me besë dhe me mall të zemrësë.

Kij mëshir', e dlira përmbi gjith' të dliuratë, për një shpirt që ty të ka mpështetur' shpresënë, dhe nga ti kërkon, me nat' e me ditë, ndihëmë të shpejtë, dhe me fuqijën' t'ënde, përmysi armiqëtë që po më luftojënë, që të të lavduronj, që brënda nga zemëra të të madhëronj, ty Nënë të Zotitë, ty shpresë të patundurë.

Shumicë mëkatash më kanë mbuluarë përmbi kry' e sipërë; porsì një barr' e rëndë me kanë plakuarë një mijzërijë trocesh; të lutem pa pushim; mos më lër mbë nj' anë mua robin' t'ënt, në këtë dit' të ngushtë, po lehtëso-më barrënë me dhimsurijën' t'ënde.



I rrahurë prej valavet' në detin' e jetësë, dhe i shkundulliturë nga erërat' të thëllimëta, që ngrejnin kundrështijatë, çonj zërin' tek ti, o Nën' e Perëndijësë, drejtomë tashti rrugënë në projtin' e pendimitë, të qet' e të lëryerë; tuke shëndërruarë në paq' e në fashë pështjiellën' e mendimëvetë.

Kush munt të rrëfenjë me gojë, o Virgjërë, vepërat' e tua, plot' me mërekullija? Se atë që s' mundin' të qyrin' me sy as rjeshtat' të Engjëjvet', ti munde t'embajsh, si fron i Qerubimëtë; atij' i lyp, e dlira përmbi gjith' të dliratë, të na ruanj' të gjithë nga cen' i ndëshkimitë, në ditën' e tmerrëme, që ka për të ardhurë.



Ti, o Zonjë, je begatij' e gjithë sa janë dorëhollë dhe ushqim e strehë për gjithë të vobegëtë dhe shpresa e bonjarvetë; dhe ty të lavdurojëmë,

ne të pikëlluarëtë, tuke të këlthiturë: o e Shenjt' e shenjtavet', nxito, sot, dhe shpëto-na, ne robërit' të tû, nga ç'do të gëciturë të frymavet' të liga, dhe nga ndëshkim' i rëndë, dhe nga të dënuarëtë për jetën' e jetësë.



Shpëto, o e Mira Nën' e Perëndijësë, atë që vjen të shtrohet ndë mprojën' e hyjme të sqetullës' s'ate; se më kan' rrethuarë shpirtin' t'im' të prujëtë, një dërmor' e madhe ngucimesh dhe trocesh, plëngjesh dhe rrëziqesh, dhe errësim i thel'ë verbimi të mënderëmë. Nxito të më ndihish sa nuk' kam harriturë në fundin' e funditë; ruajmë nga krusma e frymavet' të liga dhe nga të dënuarëtë për jetën' e jetësë.



Ç'kam un' gjëmëmadi të të shtronj përpara, o Zotësh' e botësë, përveç se çurgje lotësh dhe të sbërthyerë zemëre për bëmet' që kam bërë? Po shtjer, o Virgjëreshë, një sy përdëllimi mbi dhil' - e dobësjën' e shpirtit' t'im' të prujëtë. Shkri mjegullat' të errëta të plëngjëvet' të mijë, dhe shliro, të lutem, nga kjo dit' e ngushtë që më ka kapluarë, mua robin' t'ënt.

Ti je pushteta e ime dhe përkrahja e ime dhe mprojta e patundurë, dhe ti je ngushllimi i shpirtit' t'im' të pikurë; andaj' ngjat-i veshinë klithmës' që të bënj, o Nën' e Perëndijësë, dhe d'lr-më nga ç'do trubullimë shpirti dhe brengë të jetësë.



Lëvdim' i besëdrejtëvet' dhe mproj' e mburrim i gjithë sa janë, o Nën, për jetën' e jetës e Virgjërë, lut-iu pa pushim Birit' t'ënt dhe Hyjitë, për shpëtimin' t'ënë.

Ti, o Virgjëreshë, e plot' hire Zoti, je tempull Perëndije dhe caku i hyjëmë i Shenjtës' Trinijë, së shenjtës' mbi të shenjtatë; ti je ay lumi i gjithë mirësisjave, që rjedhën nga Parajsa; darovat' të begata të hirevet' që mëndja nuk' munt as t'i nxërë fal-u me duar' plotë gjith' robëvet' të tû, që të të bekojëmë të gjithë me besë, o Nën' e Perëndijësë, si mburonjën' t'ënë, ne që nuk' poshojm' së të lavduriari me të brohoritura.



Tungat' të zemrës' s'ime ushtuan', o Nën' e Zotitë, Ti kij-më mëshirë dhe shpëto-më syresh sa shpejt' e më shpejtë.

Ti, që të vetëmin' të pafajmin' linde, më fal hirin' e ndjesësë për gjithë mëkatat', që kam bër' në jetë, o e pazhig' e blanë.

Kur të më vinjë koha, që të përsillem jetësë, o Nën' e Perëndijësë, ruaj-më dhe shpëto-më nga leqet' të të ligutë, o e shenjta ti përmbi gjith' të shenjtatë.



**TË LUTURA T'ËN-ZOTI J. K.
PËR T'I LYPURË NGUSHULLIMIN'E TIJE
DHE NDIHMËN E TIJE TË HYJEME**

Ti që, në ç'do kohë edhe në ç'do herë, je i adhuruarë dhe i lavdëruarë në qiell edhe mbi dhë, o Krisht o Perëndi, që ke durim të math, që je mëshirëplotë, që je përdëllimtar, që i don të drejtëtë dhe për mëkatarët të vjen dhimsurijë, që thërret të gjithë në rrugën'e shpëtimitë, me të zotuarët' t'ënt të gjithë të miravetë, për jetën' e pastajme. Ti tashti, o Zot, qas edhe pëlqe të luturat' t'ona, dhe prij-i jetës' s'ënë rrugën' që shënove me porosijat' t'ënde. Shenjtëro-na shpirtinë, dëli trupet' t'anë, drejto-na gjyqimetë, këthill-na mejtimetë, edhe na

shpëto nga ç'do gullçim të keqë dhe ç'do pikël-
limë. Na vër për rreth' si mur, Engjejt' t'ënt të
Shenjtë, që, ruajtur' edhe prijturë nga rjeshtat' të
tyre, të mundim' të harrijëmë të njëjëtit të besi-
mitë dhe lavdin' t'ënt të njohimë, që s'ka si mbë-
rrihet; se ti je i bekuarë në jetë të jetëvet'. Amin.



Epu, o Jesu, ngushllimin' t'ënt, të shpejt'
e të fortë, robëvet' të tu në kohën' kur të plogura
janë frymat' t'ona. Mos na unda nga shpirti' në
kohën e brengësë, mos na rri lark nga mëntë në
kohën' e rrezikutë, po nxito gjithëherë në ndih-
mënë t'ënë. Qasu afër' nesh, na uqas përënë, ti
që je gjithëkundi; dhe sindëkur gjith' monë je me
Apostujt' t'ënt, gjithaq', o Dhimsëtar', bashko veh-
ten' t'ënde dhe me ata që kanë në zëmër' mallin'
t'ënt; që, me ty të lidhurë, të të lumërojemë, dhe
të të lavdërojemë të shenjtën' mbi të shenjtatë Fry-
mën' e Shenjtë t'ëndenë.



O, ajk' e ëmbëlsijësë, Jesu, o Drit' e botësë,
shëndrî-më syt' të shpirtitë, o Bir i Perëndijësë, me
të shkëlqyerët' t'ënt nga ndriçim i hyjëmë, për të
të lumëruarë, o drit' e pa ngrysurë.

O ajk' e ëmbëlsijësë, o Jesu, që jë dëfrim' i shpirtit' t'im, Jesu që mëndjen' t'ime ma dliçë nga gabimi, o Zot mëshirëmath, o Jesu shpëto-më. Ti Jesu, që je Shpëtimtar' i im', o Jesuj i im, që je pushtetëmath mos më leshe nga dora, o Shpëtimtar Jesu kij dhimsë për mua dhe më shpëto, Jesu, nga gjithë ndëshkimetë, dhe bëj-më të kem pjesë bashkë me të shpëtuarëtë, Jesusj' i im' më vër në radhën' e atyre që ke sgjedhur' vehtë, Jesu që dhimsurijë ke për njerëzijenë.

O ajk' e ëmbëlsijësë, o Jesu, që jë lëvdij' e Apostujvetë, o Jesuj' i imë, mburrim' i Dëshmorëve, o Zot pushtetëmath; shpëto-më, Jesu, shpëtim' i imë, mua që po vinj të të lypënj ndihëmë, o Jesuj' i imë, y'l' i bukurijësë, o shpëtimtar Jesu kij dhimsë për mua, me hirin' e të luturavet' të Nënës' që të bëri, dhe Jesu, të gjithë Shenjtorëvet' të tû, dhe të gjithë Profetëvet' dhe më bëj, Jesu o Shpëtimtar' i imë, të gëzonj dhe unë gëzimet' të Parajsitë, Jesu, që dhimsurijë, ke për njerëzijenë.

Uratë për nevojat' të gjindes' së krishterë

I fal, o Zot, ata që na kan' mërijë dhe na bëjnë keqë.

U bëj të mir' atyre që bëjnë' të mirënë.

Vëllezërvet' t'anë dhe njerësvet' t'anë u fal ato që lypin' për shpëtim të shpirtitë, dhe jetën' e pasosurë;

Vështro të sëmuretë dhe fal-u shëndetinë;

U prij rrugën' atyre që janë në det;

Përsill shtegatarëtë;

I ubëj krah mbretitë; u fal fajet atyre që na gjinden' neve me shërbes e ndihëmë;

Me mëshërirën' t'ëndë të madhe përdelle ata që na kan' vënë, neve të pavlejët, të lutemi për ata.

Kujto, o Zot, nderit' dhe vëllezerit' t'anë, që përpara nesh, kan' ndërruarë jetë, dhe ep-u të prëjturë, atje ku derdhet' drita e fytyrës s'ate;

Kujto, o Zot, ata që ndihin' për të mbarën dhe për sbukurimin' e qishavet' të tua të shenjta dhe fal-u të lypurat' të tyre për shpëtim të shpirtitë dhe jetën' e pasosurë;

Kujto-na o Zot, dhe ne, të mjer' e mekatarëtë, robërit' të tu, që s'jemi për të qënë dhe na prij në rrugën' e urdhëravet' t'ënde, me harin të të luturavet' nga an' e Nënës s'ate së dlires' mbi të dli-ratë, Mërijës, Zonjës' s'ënë, Nënës' së Perëndisë, së Virgjërës' për jetë dhe nga an'e gjithë shenjtorëvet' të tu, Amin.

**TË LUTURA FRYMËS' SË SHENJTË PËR T'Ë LYPURË
HIRIN' DHE TË SHENDRITURIT' TË SAJE
PËR GJITHË TË KRISHTERËTË.**

Mbëret qjellor, Ngushëllimtar, fryma e së vertetës, që ndodhesh kudo dhe i mbush të gjitha, thesar' i të miravet, dhe dhurëtar i jetësë; eja dhe buj ndër ne, dhe spastro-na prej ç'do pikle, dhe shpëtô, o i Mirë, shpirtet tona.

Ti, o mbret i qjellitë, shëndosh'u fuqijënë mbëretervet t'anë, që jan besëdreitë; fortëso besiminë; sbut-u frymën' kombevetë; ep-i paqen' botësë, ruaj me të kujdesurë këtë kish të shenjtë; et' e vllëzërit t'anë, të shkuarë para nesh, rjeshtojni në lëmën' ku rrijën' të drejtëtë; dhe neve, të penduarë dhe të njohur' fajetë, qas-na përënë teje, si i mir' që je, dhe që dhimsurijë ke për njerëziënë.

Ati, shpresa e ime, Biri streha e ime, dhe Fryma e Shenjtë mburoja e ime. O Trinj' e Shenjtë, qoftë për ty lavdi.



TË LUTURA PËR SHPIRTET' TË TË VDEKURVET'

Kujtò, o Zot, ata t'en' etër' e vëllezërë, që kanë mbyllur' sytë me shpresë të ngjalluri në je-

tënë e pasosurë, si edhe gjith' ata që mbaruan' jetënë me drojë të përshpirtëme dhe me besim feje, dhe fal-u ç'do mëkatë të bërë me të dashurë dhe me të padashurë, me fial' e me vepërë, ose me të menduarë. Dhe bëj-u cak të ndenjuri në vënde të ndriturë, në vënde të gjelbërë, në vënde dëfrimi, nga ku ushporr ç'do dhimtë, helëm' e psherëtimë, dhe ku të këqyruirit' të fytyrës' s'ate gëzon e ngazullon gjith' shenjtët' të tu, të shekuivet' të shkuarë. U fal atyre vënt në mbretërijën' t'ënde dhe pjesë në të mirat' të tua të përjetëshme, që nuk është gojë të mundin' t'i tregonjë, dhe bëj-i të gëzojën' jetën' e lume t'ëndenë, që nuk ka të mbaruarë. Sepse ti je jeta të ngjallurit' dhe prëjtja e robëvet' të tu, që kan mbyllur' sytë, Krisht o Zoti i ynë, dhe ty të lavdërojëmë bashkë me Atin t'ënt, që s'ka kry' e të nisurë, dhe me Frymën t'ënde, të shenjtë mbi të shenjtatë, të mirën', që ep jetë, sot e për gjith mon' e për shekuj' t' shekujvet'. Amin.





I.

Lùteje e mëngjesit

Con sentimento

Zot, të fa-lem me ha-nê sè për



tîj u gdhiva i gjall të t'shër-bénj si zot që



jë të të këm e be-së e máll te kjo jetë të të be-



-kò-ny prân te kjiel-li të t'trashgò-ny

Zot, të falem me harê,
Sè për tîj u gdhiva i gjall,
Të t' shërbénj, si zot që jë,
Të të këm e besë e máll;
Te kjo jetë të t' bekónj,
Prân te qielli të t' trashgónj.

II.

Con slancio

Pe ren-di i lar-ti yn' Zot
bashkë me në të jesh ti sot ku të
rrim ë ku të ve m se po
ty për ndih-më ke - rri Zot i
lart e Pe-ren di kës-na
t'gjith ve li-pi si e si t'vri-he
- mi me be se mos na le të
biem ndë fte - së mos na le të
biem ndë ftesë *calando* mos na le të biem ndë ftesë

Perëndi i larti yn' Zot,
Bashk me në të jësh ti sot,
Ku të rrëm e ku të vemi;
Së po tîj për ndihmë kemi.
Zot i lart e Përëndi,
Kijna t' gjithve lipisî,
E si t' truhemi me besë,
Mos na le të biem ndë ftesë.

III.

Lutëje të mbrëmës

con dolore

1 Zot i math u bie të flëë ë ngë
2 Jam ë ngu-lem te ky shtrat ë më

dî në ngre-fsha mëë shpir-tin t'im u tîj t'e
ruan yn' Zot si At po në vde-ksha te kio

stac. *pp*
lëë shpir-tin t'im u tîj t'e lëë
natë fal-më o Zot çë-do më-kehtë

pp
Ëm u ra-tën Zo-ti Krisht i

ra-tën o Më-rû Ti be-komë o Pe-rën-di

Detailed description: The image shows a musical score for a hymn. It consists of six staves of music. The first staff begins with a treble clef, a key signature of one flat (B-flat), and a 4/4 time signature. The tempo/mood is marked 'con dolore'. The first two staves contain two vocal parts: '1' and '2'. The lyrics are in Albanian. The third and fourth staves continue the melody with lyrics. The fifth and sixth staves conclude the piece with lyrics. There are dynamic markings like 'pp' and 'stac.' throughout the score.

Zot i math, u bie të flëë
Ë ngë dî në u ngrefsha mëë;
Shpirtin t' im u tîj t'e lëë.
Jam e ngulem te ky shtrat,

Ë më ruan yn'Zot, si At.
Po në vdeksha te kio natë,
Fal-më, o Zot, çë-do mëkatë.
Em uratën, Zoti Krisht;
Em uratën, o Mëri;
Ti bekô-më, o Perëndi.

IV.

Përdëllim madhit Perëndi



O i pã sos-mu Pe-rën-dî o i push



tetshmi i madhi yn'Zot. u të lypinj li-pi-



-sî tu-ke der-dhur syshit lotë



Ndj-e-na ndj-e-na i ma-dhi yn'



Zot ndj-e-na ndj-e-na i ma-dhi yn'Zot

O i pã-sosmi Perëndi,
O i pushtetshmi i madhi yn'Zot,
U të lypinj lipisî,
Tuke derdhur syshit lotë.
Ndjena, ndjena, i madhi yn'Zot.

IV.

Përdëllim madhit Perëndi



O i pã sos-mu Pe-rën-dî o i push



tetshmi i madhi yn'Zot. u të lypinj li-pi-



-sî tu-ke der-dhur syshit lotë



Ndj - e - na ndj - e - na i ma-dhi yn'



Zot ndj - e - na ndj - e - na i ma-dhi yn'Zot

O i pã-sosmi Perëndi,
O i pushtetshmi i madhi yn'Zot,
U të lypinj lipisî,
Tuke derdhur syshit lotë.
Ndjena, ndjena, i madhi yn'Zot.

Kûr mëkatën ù llojás,
Helmit zëmbra m' mblomet plot;
Po m' gënjen i bushtri gas,
È t' fëjënj, o i madhi yn' Zot.

Nndjena, ndjena, i madhi yn' Zot.
Dishirònj të skomollisem;
Po ng' e gjênj ú priftin sot;
Tue shamtîjtur të lipisem,
Të më ndjesh, o i madhi yn' Zot.

Nndjena, ndjena, i madhi yn' Zot.
Psherëtînj me t' math tërbim,
Sè t' kam ftesur shumë mot;
Poi kâ t' shkulet shpirti i im,
Se t' fëjënj mëë para, o Zot. Ndjena...
Gjith të ligat unë i shkofsha,
Edhè zënsha fill c'ë sot;
Edhè vdèkjën e durofsha,
Po s' dua mëë t' fëjënj, o Zot. Nndjena....
Ligësîn e gjellês t'ime
Dua t' harrònj, è tîj, ç' ë sot,
Dua të kê m te zëmëra e ime,
Vetëm tij, o i madhi yn' Zot. Ndjena...
Rrofsha edhè në varfëri,
Nndêr mos patsha è porosî;
Po ti kijëm lipisî;
Mos më le në faj, o Zot. Ndjena...

V.

Më parë se Kungimi

Con affetto

Ej - a o Zot e Pe - rën - di

në ktë zë - mërë e në ktë gjî u të

përës me lotë ndë sy me gëzim ë

trëm - bë - sî u të përës me lotë ndë

sy me gë - zim ë trëm - bë - sî

rall...

The musical score is written on five staves. The first staff begins with a treble clef, a key signature of one flat (B-flat), and a time signature of 2/4. The tempo marking 'Con affetto' is placed above the first staff. The lyrics are written below the notes. The final staff includes a 'rall...' marking above the notes.

Eja, o Zot e Perëndi,
Në ktë zëmërë e në ktë gjî;
Të përës me lotë ndë sy,
Me gëzim e trëmbësi,
Me tërbim e me harë,

Te ky shpirt që mua më dhê.
Për këtë shpirt te jeta jerdhe
E për mua gjith gjakun derdhe
Pr'atë gjak të parkalës,
Ip më hir sa mos të t'ftes.
Perëndi tri herë shejt,
Te kjo zëmër' eja shpejt,
Si nga dielli rrëmp i mirë
N'dë të thellët errësirë.
Eja shpejt e mos mënò,
Ë këtë shpirt më shejtërò.
Mos t'vërrësh, o i madhi yn' Zot,
Se ù jam një grushtëth bot;
Po t'kujtosh se ti jê At.
Eja njize somenát.



VI.

Pas Kungimit

Gëzou, gëzou, o shpirti jim
Harrò ftesat, rî me gëzim.
Gjella zù e vdekja sosi,
Yn'Zot me hirë të kjosi.
Aì t'ushqjen em buk e verë
Të kujtonesh kurdoherë:

Sâ të deshi e sà pesoi
E sâ gjak e diers duroi.

Oh çë e madhe dashurî!

I Zoti vjën te një mavrî;
Te një mavrî si u i mjerë,
Rii fshëhur në buk e verë.
Oh! çë mistër i madhi kî!
U' gjë ngë shoh e t' jëtër s' dî:
Zoti Krisht i njërëzuar
Tek' u rrî i levdëruar.



Rrî si mik edè si At

U' gjë ngé shoh e t' jëtër s' dî:
Bekuar Ti klòfshë, i madh' yn' Zot!
I hàbitur, me syt ndër lot:
Tij të fal zëmbrën t' ime
Tue thritur po nga thrime:
Shejtë Ti jè o Perëndî,
Shejtë Ti jé e me fukî
Për mëmën e t'in' Zoti,
Shpojëm mua çë faj ndoti;
Se Ajò, me dhime e lòt
Këtë gëzim là neve sòt.
Këtë gëzim, ktë ëmbëlsì
Çë më ngrohi të ftohtin gjî,
Tij të fal e të dëftónj
Për sâ mot u do të rronj.

VII.
Shpirtit Shejt

The musical score is written on five staves. The first staff begins with a treble clef, a key signature of two flats (B-flat and E-flat), and a 3/4 time signature. The melody is written on a single line. The lyrics are written below the notes. The second staff continues the melody. The third staff includes the instruction 'Ritornello' written above the notes. The fourth staff continues the melody. The fifth staff features a more complex rhythmic pattern with eighth and sixteenth notes, and includes the instruction 'E - ja' written above the notes. The lyrics are written below the notes.

E ja Shpirt e Pe - rën di për vë
- lo më ti ktë gjë u t'ë pë rës me di - shi - rim shej t'ë
rò më shpirtin t'im E - ja
Shpirtit Shejt i im eja e ndru te shpirtin t'jm

Eja, o Shpirt e Perëndi,
Përvëlo më ti ktë gjë:
U t' pë rës me dishirim,
Shejtërò-më shpirtin t'im.
Eja, o Shpirti Shejt i im,
Eja e ndrite shpirtin t'jm.
Flakë e gjallë e Shpirtit Shejt,
Dhizëm zëmbrën t' ime shpejt,

Eja, o Fryma e Parakletë,
Ngushëllò-më me të vërtetë.
O parràis i shpirtit t' im.
Mblò-me zëmbren me gëzim.
Dritën t' ënde, o Shpîrt, dhuròna;
Dhis me zjarrin zëmbnat t' ona.

VIII.

U të falem, o Mëri

Dolce

1 Fa - lem Vir - gjë - rë e dë -
2 Zo - nja e ma - a - dhe e shën

- li - rë o e hir - plo - ta e shën Më - ri
Me - ri më - më et' lar - tit Pe - rën - di - i

mbi gjith' grá - át ti jë e fat -
kuj - na má - all e da - shu -

- mi - rë së t' Pa - sos min kë - ë
- ri i kuj - j - na gjith - ve li - pi -

ndë gjí klo - ofsh' e lu - me
si - i per - në Bi - rin

për gjith' mo - në bashkë me Bi - rin t'ënd'ën -
le - tu o më më si e dhë sot t' he - ra te he - ra e

Lo - në A - shtu - kloft A - shtu - kloft
mbrie - më

Falem, Virgjërë e dëlirë,
O e hir-plota e shën Mëri;
Mbi gjith' grât ti jê e fatmirë,
Sè t' Pâ-sosmin kê ndë gjî.
Klofsh' e lume për gjith-monë,
Bashk me Birin t'ënd t'ën Zonë.



Zonja e madhe e shën Meri,
Mëmë e t' lartit Perëndi,
Kijna mâll e dashuri,
Kijna gjithve lipisî;
Per në Birin lutu, o mëmë,
Si edhè sot te hera e mbrëmë.

IX.

O Mëma e dëshurë

Largo affettuoso

O me - ma e dè - shu - rë

e - shën - Më ri - i pà tîj i gzu - a - rith,

të - . rronj ngjë dî me pshërë - ti - me të thom nga

thu - me me ma i - me o me ma i me

The musical score is written on five staves. The first staff begins with the tempo marking 'Largo affettuoso' and a 3/4 time signature. The melody is written in a treble clef with a key signature of one sharp (F#). The lyrics are written below the notes, with some words split across lines. The score includes various musical notations such as slurs, accents, and triplets.

O mëma e dëshurë,
E shën Mëri,
Pà tîj i gzuàrith
Të rronj ngjë dî;
Me psherëtime,
Të thom nga thime:
O mëma e ime,
O mëma e ime.

Dzura të thrisja
Çë kur u leva
E te kjo zëmbërë
Thellët të preva,
Pra, me lëvdime
Të thom nga thrime:
O mëma e ime,
O mëma e ime.



Po shih, o e bukurë,
Sa armikj me vijën;
Po shih si t'èrrurit
Në Pisë m'shtijën;
Tîj, me rënkime
Truhem nga thrime,
O mëma e ime,
O mëma e ime,
Po tîj, o Virgjërë.
U kam për mëmë;
Për bîr nga i Ngrykjuri
Të kleva dhënë.
Pra, me lëvdime
Po thom nga thrime:
O mëma e ime,
O mëma e ime.

Te jeta e lúftavet
Kurr mos harrò-më
Te hera e vdëkëjes
Ti ngushellò-më
U, me bekime
Do t' thom nga thrime:

O mëma e ime,

O mëma e ime,

Kúr te Parràisi
Të vinj ndë-vonë,
Bashk me të lùmurit
U për gjith-monë.
Po me këndime

Do t' thom nga thrime:

O mëma e ime,

O mëma e ime.



X.

Lëvdoni Mërin

Lëvdoni Mërin
O jù të krështerë;
Lëvdóni e ngâ herë,
Sè pruri lirin.

Lëv - do - ni Më - ri - in o -
ju të kri - shte - rë lëv - do - ni nga -
he - rë së përu - ri li - rin Lëv -
do - ni Lëv - do - ni Lëv - do - ni Më - rin

Lëvdoni, lëvdoni,
Lëvdoni Mërin.

Si lil e dëllirë,
O Virgjërë, u leve,
Për tîj edhë neve
I Larti do mirë.

Në garbët të vetë,
Si bîr, e njerzove,
Ë ashtu na shpëtove
Nga armiku për jetë.

Nnga zgjedha më e rëndë
Na ndzore, o Mëri,
E drekjin e zî
E shkele me këmbë.

Mbi t'jerët te qjilli
Për syllë jê e para;
Të vrëren përpara
E hënxa edhe dielli,
Yn' Zot të buroi
Me ndêr e me hie,
Të búkurit krie
Me hij të rrethoi.



Me kënka e të rënë
Shejtorët t'levdojën
Edhë te bekojën,
Si zonjë e si mëmë.

Si zonjë e si mëmë
Ti kîjna mëshirë,
Te hera e vështirë
Të vdëkjës t'ënë.

O mëmëza e jonë,
O Zonja e bekúarë,
Të klofshim të trúarë
Për mot e për monë.

XI.

Po rroft Shën Mëria

The musical score is written on four staves. The first staff begins with the tempo marking 'Adagio' and a time signature of 3/4. The lyrics 'Po rroft Shën Mëria' are written below the notes. The second staff continues the melody with the lyrics 'me t'ë dâ-shu-ri in bî: ù. se'. The third staff is marked 'Ritornello' and contains the lyrics 't'a-nët për hîr i pru. ru këtù Po'. The fourth staff concludes the piece with the lyrics 'ft Shën Mëri-a Po rroft Shën Mëri a'. The score includes various musical notations such as notes, rests, and dynamic markings.

Po rroft Shën Mëria
Me t' dâshurin bîr,
Çë t' anët për hîr
I pruri këtù.

Nnga vendet e 'tyre
Arbreshët-Shkjiptarë,
Të besës luftarë,
I reshti me 'të.

Për besën e Zotit
Të pasurat lanë
U nisën e vanë
E jikën me 'të.

Te nata, si nj' izë,
I prîjtë me dritë,
E i solli në ditë,
Si 'rêzë, me 'të.

Nndër fusha e ndër pyje,
Nndër malet i shkoi,
E dëjtin ndërroi
Ndë sterë për 'ta



Nga viset e dâshura,
Ku shumë u nderuan,
Ku trima u dëftuan
I pruri këtù.

Tsa male edhe Shkëmbin,
Një shesh atà gjetën;
Me shpresën u mbatën,
Mos t' vdisjën këtù.

Mëë para te rrëzat,
Ku tendazit kishën,
Të Zonjës bëën klishën,
Çë ndodhet dhe sot.

Ku vete gjith kombi,
Me lotë ndë sy,
E « t' falem Mëri »
Tue shprejtur, përthót.

Nngë mënt të rrëfienj
Gjith hiret që kâ,
Çë sheh e që pà
Katundi arbëresh.

Shëndetin e pakjen
Dhuròn kûj i duhet,
E gjegjet që i truhet
Kjò Perëndeshë.



Lëvdohu, katunt,
Për fatin që kê,
Sè i dashur ti jê
Nga mëma e vërtetë.
Ajó me mëshirë
Nën skjepit të mbân,
E shkripes i ngjân
Mbi çerdhen e vetë.

O Zonja e Parraisit
Çë akjë na do mirë,
Të bardhë e të lirë
Te shpirti na shto.

Te viset e hùaja,
Ku dritën na pâm,
Ku 'Arbërin klâm
Ti mos na harró.

Shkon moti si lumi,
Rrî dielli edhe ngrëhet,
Por ujë ngë bëhet
Te remat kí gjak.

Te zëmbra e jonë
Një goxdë po kemi
Të gjithë sâ jemi,
Kush djalë e kush plak.

Shpëresën e motshme
Po bën-na të rê;
Si mëmë çë jê
Mbaroje njëmént.

Ti ndihna të shkojëm
Nga Prindërat erdhën,
Ku gjækuthin derdhën,
Për t'ëmbëlin vent.

XII.

Krishtlindia



Kûr Shën Më - ru i - i - i - a te e



fto - o hta shpel - le ndë - na të t' the - llë J - i -



si - in na dha me shëj tet du - ar



mbë krahë e mu - ar e për - gë -



zo - i e - dhë e kë - n - do - i

Kûr Shën Mëria,
Te e ftohta shpelë,
Ndë natë t' thellë,
Jisûin na dha,

Me shejtet duar,
Mbë krahë e muar,
E përgëzoi
Edhë e këndoi:

Të lut, o Bîr,
Me dashurî,
I jetës zot.

Çë t' math shërbës
Shoh ë kam bësë!
Atë cë m' bëri
U bëra sot!



Kush mënt t' e thoshëj!
Kje Faremiri,
I pâ-kufiri
Te djeba rrî,

Si i vogël djalë,
Çë ngë kâ fjalë;
Si edhë një i vapkëth,
Një Perëndi!

U thom ndë vëtëhe:
Çë t' math këshill
Ti pate, o Bîr,
T' vije këtù!

Sâ një njeri
T'ish Perëndi,
Ti leve è u bëre
Djalëth kështu.

Thùajmë përsè,
E Larta Fjalë,
Si i vogël djalë,
Po klâ e rënkòn?

XIII.

Lazëri

O mirë mbrëma
Ksâj zoteri,
Çë ndë ktë sphî
Ndodhet, ù thom.

Dua t' thom një thagmë
Të Perëndis,
Çë bëë te fshati
I Betanîs.

Ish një njeri
Çë kluhej Lazër;
Dy motra kî
Pati e jo mëë.

Tuke bëer mirë
Rrojti gjith- monë,
E me gëzim
Shërbeu t'ën' Zonë.

Lazëri vdikj
E t' motrat la,
Pa print, pa mikj,
E në kopós.

— Si, vëllauthi yne,
Mora të mbiodhi?
Si kështù njize
Gjellën të vodhi?

Thanë të motrat
Nd' atë këkjî:
— Si lipisî
Për në ngë pat?

Prân e varrzuan
Me t' math vajtìm;
U ngren e shkuan
Te Zoti Krisht.

— O Zot, i thanë,
Në kishë klënë,
Vdekur s'e kishëm
Vëllauthin t'ënë!

— Jo mëë vajitime;
I tha yn' Zot.
Kje besa e ime
Atë çë thot:

Se jam u gjella;
Jam ngjallësia;
U Perëndia,
U Krisht Zot.

Niset ahìerna,
Në fshat arrëen;
— Nani tregomni
Ku kalltur ëë.

Në varr u kjas
Me syt plot lotë.
— Ndzírni atë rrasë,
Gjindes i thot.

Me zëë të math
Thërrèt e thot:
— Dil jasht, o Lazër,
Ngreu nga ajò botö!

Eja t' mësòsh
Gjindes së lënë
Çë vjen më thënë
Kjo morë e shkretë.

Lazëri ngrëhet
Nga varri i zî,
Ë i jep lëvdî
Të madhit Zot.

— S' mënt të ju shtiell,
Prân gjindes thot,
Çë helm i madhi
Isht ajò botë.

Vetëm ju thom
Se kush bën mirë,
Do t' gjenjë t' mirë
Te tjetra jetë.

XIV.

Udha jonë për ndë Qiel

Shtëpî t'im Et ishtë ndë qiell.
Për atje po udhëtonj
Dot' shoh Isun' shpëtîm çë iep,
Për atje po udhëtonj.

Të dashurit çë dëshironj
Un' shpejt ata dot' i shikonj
Dhe zën e ëmbël dot dëgjonj
Për atje po udhëtonj.

Me bes' parajsinë e shikonj.
Për atje po udëtonj;
Ku faj të hynjë nuk kuzon,
Për atje po udhëtonj.

O udhëtar i lodhurë
Dot gjesh ventë për të prjturë;
Nga frik' e vdekje ti shpëton,
Për atje po udhëtonj.

Po vijmë ne o Zot' i madh!
Udha jonë po mbaron
Ku Zoti Krisht më para ka ardh;
Dhe për jetë po mbretëron.

Edhe të vdesë trupi im,
Shtëpi të ndritëme na ep;
Vdekja për ne ishtë fitim,
udha jonë po mbaron.

XV.

Lidhje Vëllezërësh

Sa e ëmbël lidja e jon,
Lum ay çë kërkon;
Zoti ndë dashurî na mban,
Prej vete nuk na ndan.

Në ishtë Ati yn
Në ishtë Shpëtimtar,
Kurora neve po na pret
Nndë qjelli nga i madhi Mbret.

Së bashku vuajmë
Shpëresa ishtë një,
Bashkë ne rojmë ndë gëzim
Se kemi një kël'im.



Kur helmi na harin
Dhe na redhon shtrëngim,
Derdhim ne lote me kuzim
Falëmi pa pushim.

Ndarja ndë këtë dhë
Zëmbratë na helmon,
Po ne dot mblidhemi ndë qjelli,
Kjo gjë fort na gëzon.

Atje helm nukë ka,
Të klarë edhe vaj;
Lote atje më nukë ka,
Sepse atje s'ka faj.

XVI.

Krishti pret fajtorëtë.

Krishti pret fajtorëtë

Epni botës këtë zë:

O fajorë kthehuni, merni këtë dhuretë.

Epni botës këtë zë:

Krishti pret fajorëtë;

Kthielët flisni këtë gjë,

Krishti pret fajtorëtë



Krishti pret fajtorëtë

Si dhe mua prej ç' do faj,

Mua sot ay më lan nga ç' do ligësi e faj.

Epni botës këtë zë...

Ejani tek Iisuj

Për ne kji ka derdhur lot;

Ndjes e prëhje gjithë kujt, po ep me dorë

[plot.

Epni botës këtë zë...

XVII.

Lavduri

O Zot perëndi, o Ti përdëlimtar,
Ke dhën Iisunë për ne Spëtimtar!

Allilua! të këndojmë, allilua. Amin.

Allilua! falë kloftë të Lartit. Amin.

O Zot Iisu Krisht! për këtë dashuri

Ti gjakunë ke derdhur të n'apëç në lëri.

Allilua! të këndojmë, allilua. Amin.

Allilua! falë kloftë të Lartit. Amin.

Be Ty Frymë Sheitë, të japëm lavdi:

Na vësh zëmbërat t'ona gjith me shëntëri.

Allilua! të këndojmë, allilua. Amin.

Allilua! falë kloftë të Lartit. Amin.





1. Kush na ka krijuarë?

Na ka krijuarë Perëndija.

2. Kush është Perëndija?

Perëndija është e Qënmeja më e përsosurë, Krijetari dhe Zoti i qjellit' dhe i dheutë.

3. A ka trup si ne Perëndija?

Perëndija nuk ka trup si në, Perëndija është frymë e thjeshtë; ay është në qjell, në dhe e në ç'do vënt.

4. Përse na ka krijuarë Perëndija?

Perëndija na ka krijuarë për t'e njohurë, për t'e dashurë dhe për t'i shërbyerë në këtë jetë edhe për t'e gëzuarë në jetënë t'jetërë në Parajsë.

5. A është një i vetëm' Perëndija?

Perëndija është një i vetëm, po në tre Vhtë të njënjëjetë dhe të shquarë, që quhenë: At, Bir e Fryma e Shenjtëruarë.

6. A uvesh me mish e ubë njeri ndonjë nga të tre Vehtët' të Trinitijës së Shënjtë?

Nga të tre Vehtët' të Trinitijës' së Shenjtë uvesh me mish e ubë njeri i dyti, domethën Biri, që quhet Jesu Krisht, i cili është Perëndija e vërtetë dhe Njeri i vërtetë.

7. Përse ubë njeri i Biri i Perëndisë?

I Biri i Perëndisë ubë njeri për të na shpëtuarë, domethënë për të na shpërblyerë nga mëkata dhe për të na bërë të fitojm' prapë Parajsën, tuke vuajturë mundime dhe tuke shkrijturë vehten' mbi kryq.

8. Ç'është Kisha?

Kisha është shoqërimi i të Krishterevet' të vërtetë, domethënë i të pagëzuarëvetë, që njohin' fen' e mësimin' e Jesu Krishtitë, që kanë pjesë në Sakramentat' të Tija dhe që u binden' barijvet' të vënë prej Sajë. Kisha ka qe themeluarë prej Jesu Krishtitë.

9. Cilët janë Barinjët' të ligjësmë të Kishësë?

Barinjët' të ligjëshmë të Kishësë janë Papa, Patriketë edhe Ipeshkëvet' të bashkuarë me të.

Papa është trashëgimtari i shën Pietritë dhe prana krye i dukurë i gjithë Kishësë, Zënvëndës i

Jesu Krishtitë, që është krye i sajë i padukurë ndër syt të njerëzisë.

10. Cilat' janë mështeret' të kryeparë të fesë?

Mështeret' të kryepara të fesë janë dy: Njënija dhe Trinija e Perëndijësë edhe të Veshurit' në mish, të Pësuarit' mundimetë dhe të vdekurit' të Zotit' t'ënë Jesu Krishtitë. Këta dy mështerë të fesës i dëshmojnë e i shfaqim edhe me shënjën e kryqitë.

11. Si bëhet' shënja e kryqitë?

Shënja e kryqit' bëhet' tuke çuarë mbi ballë dorën e djathëtë me tre gishtëra të parë të bashkuarë mbë një, dhe tuke thën fjalët': në emër' të Atitë, pastajë tuke i prurë mbi krahëruarë dhe tuke thën: dhe të Biritë; pastaj mbi sup të djathët' e të mëngjerë tuke thën fjalëtë: dhe të Frymës së shenjtë, dhe mbaron me fjalëtë: amin; ashtu qoftë.

12. Ç'janë Urdhërimet' të Perëndijësë?

Urdhërimet' të Perëndijësë ose Dekalogu janë ligjet' morale, që Perëndija, në Dhjatën' e Vietërë i dha Mojsiut' mbi malin' Sinaj, dhe që Jesu Krishti ndreqi e miroj' në Dhjatën e re.

13. Ç'është mëkata?

Mëkata është faji faqe Perëndijësë tuke mos i u bindurë ligjës' së Tijë.

14. Mbë sa mënyra bien njeriu në mëkatë?

Njeriu bjen në mëkata mbë katër' mënyra, domethën me mënt, me fjalë, me vepëra dhe me harresë.

15. Sa llojësh është mëkata?

Mëkata është dy llojësh: mëkata e rëndë dhe mëkata e falëshme.

16. Ç'është mëkata e rëndë?

Mëkata e rëndë është të mos bindurit' ligjës' së Perëndijësë në gjasenda me rëndësi, të bërë me plotë mëntë në krye dhe me vulnet të plotë.

17. Ç'është mëkata e falëshme?

Mëkata e falëshme është të mos bindurit' ligjës' së Perëndijësë në gjasenda të lehta ose dhe në gjasenda me rëndësi, po pa pasurë mëntë plotë në krye dhe pa vulnet të plotë.

18. Cilët' janë urdhërimet' të Perëndijësë?

Urdhërimet' të Perëndijësë janë:

I. Unë jam Zoti Perëndija i yt; të mos kesh Perëndij' t'jetërë përveç meje.

II. Nuk dot' zësh në gojë emërin' e Perëndijësë mbë të kotë.

III. Kujtou të shenjtërojsh të krëmtetë.

IV. Ndero t'ët-at dhe t'ët-ëmë.

V. Të mos vrasish.

VI. Të mos bëjsh punë të fëlliqëta.

VII. Të mos vjedhish.

VIII. Të mos bëjsh dëshmijë të rremë.

IX. Të mos dëshërojsh gruan' e t'jetërë-kuji.

X. Të mos dëshërojsh gjërin' e t'jetërë-kuji.

19. Ç'na urdhëron urdhërimi i parë?

Urdhërimi i parë: Unë jamë Zoti Perëndija i yt; të mos kesh Perëndij' t'jetërë përveçë meje, na urdhëron të jemi besëtarë, domethënë të besojm' Perëndjiënë dhe t'e duamë, t'i falemi dhe t'e shërbejmë.

20. Ç'na ndalon urdhërimi i dytë?

Urdhërimi i dytë: nuk' dot' zësh në gojë emërin' e Perëndijësë mbë të kotë, na ndalon të përmëndurit' emërin të tijë pa të ndruejturë, të truajturitë, të bërët' bê të rreme të parrug' e të paudhë.

21. Ç'na urdhëron urdhërimi i tretë?

Urdhërimi i tretë: Kujto të shenjtërojsh të

Kremtetë, na urdhëron të nderojmë Perëndijënë për ditë të krëmtë me vepra adhurimi, ndër të cilat Mesha e shenjtë është në krye të parë për të Krishterëtë.

22. Ç'na urdhëron urdhërimi i katërtë?

Urdhërimi i katërtë: ndero t'ët-At dhe t'ët-Emë, na urdhëron të duamë, të nderojmë dhe t'i ndëgjojëmë prindërit' dhe të mëdhenjët' t'anë.

23. Ç'na ndalon urdhërimi i pestë?

Urdhërimi i pestë: të mos vrasish, na ndalon të vrasim t'jerë, të vrasim vehtenë, të dalimë në përgjishte, të plagosimë, të rrahimë, të shajëmë, dhe të bëjmë' punë për faqe të zezë .

24. Ç'na ndalon urdhërmi i gjashtë: të mos bëjsh punë të fëlliqëta?

Urdhërimi i gjashtë: mos bëjsh punë të fëlliqëta na ndalon ç'do fëlliqërijë, pranë ç'do veperë, ç'do fjalë, ç'do fëjyerë me sy, ç'do vivëllë, ç'do fytyrë ç'do pamë të fëlliqëtë.

25. Ç'na ndalon urdhërimi i shtatë?

Urdhërimi i shtatë: të mos vjedhish na ndalon t'i bëjmë dëm të afërmit' t'ënë në gjërin' e tijë.

26. Ç'na ndalon urdhërimi i tetë?

Urdhërimi i tetë: të mos bëjsh dëshmi të rremë, na ndalon ç' do gënjeshtërë dhe ç' do të cenuarë të nderit' të jetërë-kuji me të padrejtë. Na urdhëron të thomi të vërtetën ne kohën dhe në vendin e sajë.

27. Nga ç' punë na ndalon urdhërimi i nëndë?

Urdhërimi i nëndë: të mos dëshirojsh gruan' e jetërë-kuji, ma ndalon nga të mejtuarat' dhe të dëshiruarat' të liga. Na urdhëron pastaj të dëlirët' të plotë të shpirtitë.

28. Ç' na ndalon urdhërimi i dhietë?

Urdhërimi i dhietë: të mos dëshirojsh gjërin' e jetërë-kuji na ndalon nga të lakmuarët' të tepëruarë të pasurijësë.

Pakëzim, Krezëmë a Myron, Efharist'jë, Rrefyerë,
Efqël'ijë, Priftërim, Martesë.

29. Ç'është Pagëzimi?

Pagëzimi është Sakramenti që na bën krishterë, domethën ushtarë të Jesu Krishtitë, bij' të Perëndijësë dhe pjesëtarë të Kishës.

30. C'është Krisma a Mirosuritë?

Krisma a Mirosuritë është Mysleri që na bën të Krështerë të plotë edhe ushtëtarë të Jesu Krishtitë.

31. Ç'është Kungimi d. m. th. Efkaristija?

Eshtë mysleri që në trajtë buke dhe vere, përshfaqën në të vertetë Trupin, Gjakun' Shpirtin dhe të Hyjëmit' të Zotit t'ënë Jesu Krishtitë, për ushqim të shpirtëvetë.

32. Sa sende janë të nevojëshme për të bër një kungim të plotë?

Janë tre:

1) të jetë njeriu në hir të Perëndijësë;

2) të dijë dhe të ketë në kujtim se ç'është Kungimi;

3) të mos ketë vënë gjë në gojë nga mezi i natësë.

33. Ç'është të jetë njeriu në hir të Perëndijësë?

Don të thotë të ketë ndërgjegjën të dëlirë nga ç'do mëkatë të rëndë.

34. Qysh duhet' agjëruarë përpara të kunguaritë?

Duhetë agjëruarë në mënyrë të plotë, dome-

thënë se nuk' duhet' vënë në gojë asgjë që të jetë lëndë të ngrëni a të piri.

35. A është pun' e mirë dhe e mbarë të kungohet njeriu shpeshë herë?

Eshtë punë tepër e mirë dhe tepër e mbarë të Kungohet njeriu shpeshë herë, aty edhe për dita me qënë, harrin vetëmë që të kunguaret' të bëhet' me kushtet' që i kan' hije.

36. Ç'është Mesha a Liturgija e shëntë?

Eshtë Sakramenti i storature prej Jesu Krishtitë që në gjasë të bukës' dhe të verës' i bëhet' Perëndijësë mbi alltar prej meshëtaritë, për kujtim dhe të përtëriturë të shugurimit' të Jesu Krishtitë mbi Kryq.

37. Ç'është Pendesa d. m. th. Rrefyerëtë?

Eshtë Sakramenti i storature prej Jesu Krishtitë për të larë mëkatat' t' bëra pas pagëzimitë.

38. Sa janë sendet' që lypen për të bërë një Rrefyerëtë të plotë?

Për të bërë një Rrefyerëtë të plotë duhen pesë sende, që janë këto:

1) Të rëmuarët' dhe të kërkuarët' thellë ndër-gjegjënë;

2) Të penduaret zëmëres' për mëkatate;

3) Të ndarët' me zëmër' e me mënt të mos përsëriturit' të tyre;

4) Të rrëfyerëtë;

5) Të shtruarët' gjobimit' të nunërimitë.

39. Ç' është priftërimi?

Është misteri që ep pushtet të kryeri vepërimet' të shenjtë në punë Kungimi dhe në punë shpëtimi të shpirtëvetë dhe që ngëlin karakterin e meshëtarit' të Perëndijësë.

40. Ç' është Kurora a Martesë?

Është misteri që lidhin për jetë burrin' dhe gruanë dhe u falin hirin' të shkojnë jetën' bashkë shenjtërisht, dhe të rritin' fëmijëtë pas rrugës së Krishtërimitë. Ata që bashkohen' me kurorë martesë gjan të jenë në hir të Perëndjësë.

41. Ç' është urata?

Urata është të lartuarët' të shpirtit' me drojë besimi gjer te Perëndija. Urata është e nevojshme dhe duhet bërë shpeshë, sepse Perëndija kështu e ka urdhëruarë dhe ndormëtë Zoti fa'ën hiret' të Shpirtit dhe të jetësë vetëm' me anën e uratësë.

42. Ç' është Efkeliya?

Efkelia është misteri e storaturë për ngushullim shpirti dhe trupi të krishterëvet të sëmure rëndë.



MËNYRA ME SHËRBYE LITURGJIN

1. *Priifti*: ' ... Në jetë të jetëve.

Populi: Amin.

2. *Diaku*: Le t'i lutemi Zotit.

P. Mëshirô, o Zot.

3. *D.* Le t'i parashtrojmë.

P. Ty, o Zot.

Valleja: Me nërmjetimet e Hyjlindëses, Shpëtimtar, shpëtô-na.

4. Shpëtô-na, o i Bir'i Perëndisë, që u-ngjalle së vdekurësh, ne që të këndojmë: Allilua.

Lavdi Atit e Birit edhe Shpirtit Shënt, tanë e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

O i Bir' vetëm dhe Fial'e Perëndisë që je i pavdekur, dhe dignove për shëlbimin tonë, të mishërohësh prej Hyjlindëses së shëntë dhe gjithmon Virgjërës Marë, e u-bërë njeri pa ndryshuar; që u-kryqësove për ne, ô Krisht Perëndi, edhe shkele vdekjen me vdekje, që je një prej Trinisë së Shëntë dhe lavdërohësh bashkë me Atin e me Shpirtin Shënt, shpëtô-na.

5. Diaku: Urtësî, o të dreitë.

P. Ejani le t'i falemi e t'i biem nër këmbë Krishtit; Shpëtô-na, o i Bir' i Perëndisë, ne që të kendojmë: Allilua.

6. Shënt Perëndi, shënt i fuqishmë, shënt i pavdekur, mëshirô-na (tri herë). Lavdî Atit e Birit edhe Shpirtit Shënt: tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin, Shënt i pavdekur, mëshirô-na.

7. *Pr.* Paqje mi ju të gjithë.

P. Dhe me frymën tënde.

Pr. Pas Mattheut:

P. Lavdî më ty, o Zot, lavdî më ty.

(*si mbarohet Ungjilli, përseri: Lavdî më ty...*).

8. *D.* ... Le të thomi:

P. Mëshirô, o Zot.

D. ...Dëgjô e mëshirô.

P. Mëshirô, o Zot.

9. Ne që Korëzojmë mystikerisht Qerubimet dhe hymnin Trishëntor Trinisë jetëdhënëse po i këndojmë, le të hedhim lark nesh ç'do kujdes rroj-tjeje, se Mbretinë... e të gjithave do të presim, duke patur pas padukurisht Urdhëret Engjëllore. Allilua, allilua, allilua.

10. *D.* ...Lutjen tonë Zotit.

P. Mëshirô, o Zot.

D. ...Me hirin tënt.

P. Mëshirô, o Zot.

D. ...le t'i lypim Zotit.

P. Falna, o Zot.

Pr. Paqje mi ju të gjithë.

P. Dhe me frymën tënde.

D. ...që të rrëfëjmë me një mendje:

11. *P.* Atin e Birin edhe Shpirtin shënt, Trininë e njëgënëshme dhe të pandarë.

D. ...Me urtesî, le të vëm re.

12. *P.* Besoj më një Perëndî, Atin e tërëfuqishim, Krijetarin e qiellit e të dheut, dhe të gjithë të dukurave e të padukurave. E në një Zot Jesu Krisht, të vetëmin Bir të Perëndis' që lindi prej Atit para gjithë jetëve. Dritë prej Drite, Perëndî e vërtetë prej Perëndie të vërtetë, që lindi e nuk u-bë, të njëgënëshme me Atin, me anën e të cilit u bënë të gjitha. Që për ne njerëzit dhe për shpëtimin tonë xbriti prej qiejvet dhe u-mishërua prej Shpirtit Shënt dhe Virgjërës Marî dhe u bë njerî. Që u-kryqësua për ne më kohë të Pontit Pilat dhe vojti dhe u-var-

rua. Dhe u-ngjall më të tretën ditë pas shkronjave. Dhe u-ngjitë më qiell e ndënji më të diathtë të Atit, dhe do të vinjë prapë më lavdì të ggykojë të gjallët e të vdekurit, mbretëri'e të cilit do t'mos ketë barim.

Dhe më Shpirtin Shënt, Zotin e jetëdhënësin, që dërgohet prej Atit, që adhurohet e lavdërohet bashkë me Atin e me Birin, që foli me anën e profetëve. Më një Kishë të Shëntë, të Përgjithëshme dhe Apostollore. Rrëfej një Pagëzim për ndjesë të mëkatëve. Pres ngjalljen e të vdekurve dhe jetën e botës që vien, Amin.

D. ...anaforan e shëntë.

P. Mëshirë paqjeje, therore lavdërimi.

Pr. ... Qoftë me gjithë ju.

P. Dhe me frymën tëndë.

Pr. ... Lart zëmërat tona.

P. I ngremë te Zoti.

Pr. ... le t'a përhirojmë Zotin.

P. I ka hie dhe është' e drejtë.

Pr. ... duke thënë:

13. *P.* I shëntë, i shëntë, i shënt Zoti Sabaoth; qielli e dheu është plot prej lavdisë s'ate; osanna më të lartat; i bekuarë është ay që vien më emërin e Zotit; osanna ti më të lartat.

Pr. ...ndiesë të mëkatëve:

Pop. Amin (dy herë).

Pr. ... për të gjitha:

14. *Pop.* Të hymnojmë, të bekojmë, ty të përhirojmë, o Zot, dhe të lutemi Perëndia jonë.

Pr. ...Virgjërën Marî:

15. *Pop.* Të ka hie me të vërtetë të të lumerojmë ty Hyjlindësen, gjithmon-të-lumurën dhe të përmikulluarë dhe Mëmën e Perëndisë s'onë: më të nderçimen nga Qerubinet dhe më të lavdëruarën pa përqsaje nga Serafimet, që pa u-cinuar linde Fialë Perëndinë, me të vërtetë Hyjlindësen ty të madhështojmë.

Pr. ... vërtetës s'ate.

P. dhe të gjithë e të gjitha.

Pr. ... pa dënim e të thomi:

16. *Pop.* Ati ynë që je ndë qiell u-shëntëroftë emëri yt; arthtë mbretërija jotë; u-bëftë dëshira jote si ndë qiell edhe mbi dhê. Bukën tonë të përditëshme epna-e neve sot, edhe fal-na i fajet, si kundër edhe ne u a falim fajtorëve tanë; dhe mos na shtjer ndë ngasje po shpëtô-na nga i ligu.

Pr. Paqje mi ju thë gjithë.

Pop. Dhe me frymën tënde.

D. ...le t'i-a unjim Zotit.

Pop. Ty, o Zot.

Pr. Të shëntat të Shëntëve.

17. *Pop.* Një është i Shëntë, një është Zot, Jezu Krishti për lavdî të Perëndisë Atit. Amin.

D. ...Afërohuni:

Pop. Amin, amin i bekuar ay që vjen më emërin e Zotit, Perëndja zoti u-çfaq neve.

Pr. ...Beko trashgimin tënt.

18. *Pop.* Pamë dritën e vërtetë, muarmë frymë qiellore; gjetmë Besën e vërtetë, duke i u-falur Trinisë së pandarë; se ajô na spëtoj.

D. falendërojmë Zotin.

Pop. Mëshirô Zot.

D. ...le të shkojmë:

Pop. Mëshirô, Zot, (tri herë), bekô, Zot.

19. *Pop.* më emërin e Zotit — Emëri i Zotit qoft' i bekuar që tanî e gjer më jetë. (tri herë).

Pr. ...e shpëtô na.

Pop. Amin.

Diftonjësi

Urata të mëngjezitë	pag. 5
Urata Sh. Mërijesë	» 8
Urata për Engjëllin' e Rojasë	» 9
Urata mbë të ndenjurë në bukë	» 10
Urata mbë t'ungriturë nga buka	» 11
Urata të mbrëmjesë	» 12
Urata Zotit' Krisht nga ana e fëmijëve . . .	» 14
Urata Sh. Mërijesë	» 16
Urata për Rrëfiminë	» 19
Urata Zotit' Krisht për t'i kërkuarë pendesë .	» 20
Urata para Kungimitë	» 21
Urata të faluri ndërse pas Kungimit	» 24
Uratë e sh. Vasilit të math	» 26
Doksologjia	» 27
Të lutura Zonjës' Sh. Mërijë për nevoija të ndryshëme të jetëve dhe për t'i lypurë të përkrahurit' të saje	» 29
Të lutura t'ën-Zoti J. K. për t'i lypurë ngushul- limin'e tijë dhe ndihmën e tijë të hyjeme	» 37
Uratë per nevojat' të gjindes' së Krishterë .	» 39
Te lutura Frymës' së Shenitë për t'i lypurë hirin' dhe të Shendriturit' të saje për gjithë të krishteretë	» 41

Te lutura për shpirtet' të të vdekurvet' . . . pag. 41

Vjersha fetare

Luteje e mëngjezit, <i>Zot, të falem.</i> »	43
Luteje e mëngjezit, <i>Perëndi.</i> »	44
Lutëje të mbrëmës, <i>Zot i maht</i> »	46
Përdëllim madhit Perëndi, <i>O i pã-sosmi</i> »	48
Më parë se kungimi, <i>Eja, o Zot</i> »	50
Pas Kungimit, <i>Gëzou, gëzou</i> »	51
Shpirtit Shejt, <i>Eja, o Shpirt e Ferëndi</i> »	53
U të falem, o Mëri <i>Falem, Virgjërë</i> »	55
O Mëma e dëshurë, <i>O mëma e dëshurë</i> »	57
Lëvdoni Mërin, <i>Lëvdoni Mërin</i> »	59
Po rroft Shën Mëria, <i>Po rroft Shën Mëria</i> »	62
Krishtlindia, <i>Kâr Shën Mëria,</i> »	66
Lazëri, <i>O mirë mbrëma</i> »	68
Udha jonë për ndë Qiel, <i>Shtëpi t'im Et</i> »	71
Lidhje Vëllezërësh <i>Sa e ëmbël,</i> »	72
Krishti pret fajtorëtë, <i>Krishti pret</i> »	74
Lavduri, <i>O Zot Perëndi</i> »	75

Të vërtetatë të kryefillimë të fejes së

Krishtere » 76

Mënyra me Shërbye Liturgjin . . . » 87

